

VENDIM
Nr. 221, datë 21.3.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1532, DATË 19.11.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KORÇË, TË QARKUT TË KORÇËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "a", 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Në vendimin nr. 1532, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Në listën e inventarit, për pronën me numrin rendor 665 ndryshohen emërtimi dhe sipërfaqja, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 - b) Prona me numër rendor 665 i shtohet lidhjes 1 në fushën e pronave që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative.
 2. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror											
Bashkia: KORÇË											
Fusha e përdorimit të Pronës: Administrative											
Nr. Rend.	A			B			C				
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Truallit (m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera (Shënime të veçanta)	
665	8564 Ko-N-9	2/12	Ndertese +Truall	Ish Prokuroria e Rrethit Korçë. Bul.28 Nendori	1770.2	318.725	Administrata	Ish Prokuroria e Përgjithshme	Bashkia	Bashkisë Korçë do të kalojë në pronësi ambientet ku ka ushtruar funksionet Prokuroria Korçë në sip. ndërtese 318.725 m ² (sip gjurme) + 349.6 m ² (sip.katili l-rë)= 668.325 m ² . dhe trualli	
	8564 Ko-N-9	2/10	Truall funksional	Ish Prokuroria Ish Gjykata Bashkia	1561.6		Administrata	Ish Prokuroria e Përgjithshme	Bashkia	funksional me sip. 1561.6 m ² (truall i përbashkët, pas. 2/10)+1770.2 m ² (truall pas. 2/12)=3331.8 m ² . Këto ambiente do të përdoren si zyra ku ushtron funksionet Bashkia Korçë dhe trualli do të jete në funksion të tyre. Sqarohet se me kontratën e shkëmbimit me M.Drejtesisë Nr.1742 Rep. dt. 29.06.2009 Bashkisë i kalojnë në pronësi ish ambientet ku ka ushtruar funksionet Gjykata e Rrethit Korçë.	

Pas. nr. 2/10

Siperaqe Objekti = 652.4 m²
Siperaqe Parcele = 1561.6 m²


Pas. nr. 2/12

Sipërfaq Objekti = 804,0 m²
Sipërfaq Parcele = 1770,2 m²

PUNOI

Ing. E. Mucçollari

BASHKIA KORÇË
PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE



BASHKIA KORÇË
PLANIMETRIA E KATIT TE PARË

